REVISTË SHKOLLORE E M.M. "ALAUDDIN" PRISHTINË

Nr. 35 / Dhjetor 2013

DRITA e KUR'ANIT

نور القرآن

www.medreseja.com

- DASHURIA NDAJ ALLAHUT
- PSE TË LEXOSH?!



INTERVISTË ME

BAJRUSH ef. AHMETIN

Veteran i arsimit në M.M. "Alauddin"

MEDRESEJA

Të zgjodha ty Medrese
Për të më kompletuar.
Të zgjodha, sepse e dija që s'do mbes e vetmuar.
Të zgjodha sepse në ty gjeta ngrohtësi
Të zgjodha sepse, askund tjetër nuk pashë qetësi.
Shpresoj që shumë të tjerë zgjedhjen time do ndjekin
Sepse nëse e bëjnë asnjëherë të zhgënjyer s'do mbesin.
Jam vërtetë krenare që jam pjesë e jotja
E nuk do t'i dëgjoj asnjëherë për Ty fjalët e kota.
Pas meje do të vijnë shumë gjenerata të tjera
Për të ndjerë edhe ata krenarinë që unë ndjeva.
Bekimi yt shpresoj të më përcjellë tërë jetën
Vërtetë pa bekimin tënd unë e përgjysmuar do mbetem!

Merjeme Avdiu 11/3



Përmbajtja:

4 DASHURIA NDAJ ALLAHUT
6 DUAJA, ARMË E FUQISHME E BESIMTARIT
8 POZITA E FEMRËS NË ISLAM
9 PSE TË LEXOSH?!
10 INTERVISTË ME BAJRUSH EF. AHMETIN
13 RREGULLOJE JETËN DUKE PËRMENDUR ALLAHUN
14 ESE
16 TRE MINISTRAT
17 TRI SHKAQE PËR LUMTURI
18 - 22 POEZI / ESE
23 AKTIVITETE
25 KURIOZITETE / THËNIE TË MENÇURA
26 URTËSI
27 - 28 POEZI
29 KURIOZITET PËR MACET
30 TURNIRI NË FUTBOLL
31 FJALKRYQI

Fjala e kryeredaktorit

Falënderimet i takojnë Allahut xh.sh. Zotit të botëve, ndërsa përshëndetjet dhe selamet tona ia dërgojmë të Dërguarit tonë Muhamedit a.s..

Të nderuar lexues!

Revistat shkollore kanë veçori të shumta dhe ndikim pozitiv te nxënësit në përgjithësi. Ato angazhojnë nxënësit me lexim dhe u shtojnë atyre vullnetin që të shkruajnë. Ato janë freski e mendjes së tyre, meqë tekstet obligative herë herë shkaktojnë lodhje te disa nxënës. Përveç kësaj, revistat shkollore janë inkurajim shtesë drejt formimit të personalitetit të nxënësve. Ato paraqesin edhe aktivitetin që zhvillohet në mesin e nxënësve të shkollës duke dhënë një pasqyrë rreth ngjarjeve më interesante dhe arritjet e tyre, gjë kjo e cila bënë që të shtohet edhe më tepër zelli për garim në mësim dhe kreativitet.

Prandaj, jemi të bindur se revista "Drita e Kur'anit" i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret me këto synime fisnike, mbase përmban edhe mësime të shumta hyjnore. Një pjesë i është kushtuar si gjithmonë argëtimit, humorit dhe rekreativitetit, e cila është pjesë e pa ndashme e njeriut përgjithësishtë, por edhe e rinisë në veçanti.

Natyrisht, kjo punë dhe ky numër i revistës sonë nuk do të arrihej pa mbështetjen e drejtorit të shkollës Bahri ef. Simnica, e pa ndihmën e profesorëve përgjegjës. I falënderojmë të gjithë ata, ndërsa një falënderim i veçantë u takon nxënësve, pa të cilët kjo revistë nuk do të kishte margaritarët, që gjenden brenda saj.

Për fund, lexues i dashur të dëshiroj lexim të këndshëm gjersa shfleton faqet e kësaj reviste.

Kryeredaktori: Arti Mahalla

Kryeredaktor: **Arti Mahalla**

Redaktore: **Anita Gerguri**

Anëtarët e redaksisë: **Hajrullah Kerolli, Eliza Bublaku, Benjamin Emini, Ardian Mehmetaj, Shyqeri Llugiqi, Merjeme Avdiu, Veton Jashari, Blerta Brahimi, Muhamet Mavriqi, Diellza Beqiri, Redon Syla, Sara Ajvazi.**

Redaktore gjuhësore: **Shahë Memishi**

Dizajni: **Bashkim Mehani**

E-mail: **redaksia_v@ hotmail.com**
redaksia_d@hotmail.com
www.medreseja.com

DASHURIA NDAJ ALLAHUT

Të flasësh për dashurinë ndaj Allahut xh.sh. është sikur të notosh në një oqean që nuk ka brigje. Lloji më i dobishëm, më i sinqertë, më i lartë dhe më madhështorë i dashurisë pa dyshim që është dashuria e Atij, i Cili i ka krijuar zemrat të duan dhe krijesat e të Cilit ekzistojnë që ta adhurojnë Atë. Dashuria ndaj Allahut xh.sh.i jep kuptim jetës sonë, i jep ëmbëlsi imanit tonë.

Allahu i Madhërishëm thotë në Kur'an:

"E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë (duke i konsideruar) si të barabartë me Atë dhe duke i dashur ashtu siç duhet Allahu. Por ata që besojnë e duan shumë më tepër Allahun (se sa që i duan idhujtarët idhujt e tyre)" (El Bekare: 165). Ibni Kajimi ka thënë: Një nga themelet kryesore të robërimit është dashuria ndaj Allahut dhe manifestimi i dashurisë vetëm ndaj Tij. E gjitha ajo dashuri medoemos duhet të jetë vetëm e vetëm për shkak të Tij dhe ndaj askujt tjetër nuk duhet shprehur dashuria siç shprehet ndaj Tij."

Dashuria ndaj Allahut xh.sh. është ushqim i patjetërsueshëm për zemrën. Ajo është ilaç, të cilin nëse dikush nuk e zotëron, atëherë zemrën e tij e sulmojnë sëmundjet. Ajo është dritë të cilën nëse dikush e humb, atëherë ai shëtitet nëpër detin e errësirës. Ajo është ëmbëlsi të cilën nëse dikush nuk e zotëron, atëherë e tërë jeta e tij është me brenga dhe dhembje.

Për këtë kemi argument dhe fjalën e Pejgamberit a.s.: Ka transmetuar Enes ibn Maliku (r.a) prej të Dërguarit a.s. të ketë thënë "Te ai që gjenden tri gjëra, do të gjejë ëmbëlsinë e imanit: Që Allahu dhe i Dërguari i Tij të jenë më të dashur se kushdo tjetër, nëse e do dikë ta dojë vetëm për hirë të Allahut, që të urrejë, të kthehet në mosbesim pasi që Allahu e ka shpëtuar prej tij ashtu siç urren të hidhet në zjarr." Sufjan ibn Ujejne ka thënë: "Pasha Allahun, nuk do të arrini në majën e këtyre gjërave deri sa nuk e doni Allahun xh.sh më shumë se gjithçka, ndërsa kush e do Kur'anin, ai e ka dashur edhe Allahun xh.sh. Këtë dashuri të madhe për Allahun e kanë kultivuar shumë besimtarë të denjë që nga sahabët, tabiinët dhe shumë dijetarë të devotshëm. Ata kanë sjell fjalë që kanë buruar nga zemra e ushqyer me dashuri dhe sinqeritet, kanë sjellë veprat që janë shembujt më të mirë të mundshëm për dashurinë ndaj Allahut xh.sh Transmetohet se Pejgamberi a.s. po i tregonte Ubejd ibn Kabit, se Allahu xh.sh e ka përmend në suren Bejineh. Ky Sahabi i nderuar filloi të qaj dhe kështu veproi disa ditë për shkak të gëzimit që e ka përmend më i dashuri i tij Allahu xh.sh Madje sa herë

që i shihte Pejgamberin a.s. e pyeste: O i Dërguar i Allahut mua më ka përmend Allahu? Pasi që merrte përgjigjen, prapë fillonte të qante nga gëzimi. Selim En-Nehaiu ka thënë: Një natë e kam dëgjuar Ukbe ibn Gulamin, që e ka kaluar natën duke thënë: O Allahu im, nëse më dënon të dua, nëse më mëshiron të dua, sepse dashuria ndaj Teje ka zënë tërë zemrën time.

Ndërsa Jahja ibn Muadhi ka thënë:Një fije dashurie është më e dashur për mua sesa shtatëdhjetë vjet adhurimi pa dashuri.

Mënyrën se si e shprehte Muhamedi a.s. dashurinë ndaj Allahut të Madhëruar e gjejmë në të gjitha aspektet e jetës së Tij. "Kur fillonte shiu Pejgamberi a.s. dilte që të lagej me shi. Kur e pyetën se, përse po e bënte këtë, u tha: po vjen nga Zoti.

Pra dashuria për Allahun vjen atëherë kur besimi është shtrirë në çdo qelizë të zemrës, sepse dashuria e Allahut në këtë botë është një parajsë, nëse nuk shijohet, atëherë nuk mund të shijohet as ajo e botës tjetër. Ashtu siç nuk krahasohen kënaqësitë e xhennetit me kënaqësitë e kësaj bote, ashtu edhe kënaqësitë e kësaj bote e humbin vlerën para kënaqësive që të jep dashuria për Allahun. Për këtë Fet'hel-Mesili ka thënë: "Ai që e do Allahun nuk gjen kënaqësi tjetër më të madhe në këtë jetë dhe nuk e shpërfillë përkujtimin e Allahut për asnjë çast. I Dërguari i Allahut e kërkonte dashurinë në tri nivele:

1. Dashuria drejtuar Allahut.

2. Dashuria drejtuar atyre njerëzve që e donë Allahun .

3. Dashuria ndaj veprave që do të shpijnë drejt Allahut.

Kjo do të thotë që "Dashuria për Allahun" do të jetë në qendër të zemrës.

Ai që dashuron kërkon të jetë së bashku në çdo moment me atë që dashuron, ka mall për të, e përmend çdo herë dhe nuk ngopet duke e bërë një gjë të tillë.

Hasan El-Basriu ka thënë: Shumë prej njerëzve pretenduan se e duan Allahun, por Allahu xh.sh i sprovoj me këtë ajet Kur'anor:

"Thuaj nëse e doni Allahun atëherë ejani pas meje që Allahu t'ju dojë dhe t'ju falë mëkatet tuaja se Allahu është Ai që falë shumë, mëshiron shumë" (Ali Imran: 31) Pra, Allahu xh.sh urdhëron Pejgamberin a.s t'u thotë njerëzve që nëse e donë vërtetë Allahun, argument i dashurisë së Tij të jetë pasimi i të Dërguarit të Tij Muhamedit a.s. Kjo dashuri e madhe për Allahun xh.sh duhet

të ngulitet thellë në zemrat tona, në mënyrë që të shpresojmë në shpërblimin e Tij në Ditën e Gjykimit. Transmetohet nga Enesi r.a., i cili thotë se një njeri e pyeti Muhamedin a.s. ,se kur është Dita e Gjykimit? I Dërguari i Allahut i tha: "Çka ke përgatitur për të? Ai tha: Dashurinë ndaj Allahut dhe të dërguarit të Tij. I tha (Pejgamberi a.s): "Ti je me ata që i do". Enesi r.a. pas kësaj tha: Pas pranimit të Islamit nuk i jemi gëzuar askujt më shumë sesa fjalëve të Pejgamberit a.s: "Ti je me ata që i do"

Ebu Jezidi është pyetur për karakteristikat e atij i cili e do Allahun dhe karakteristikat e atij që e do Allahu, dhe tha: "Kush e do Allahun ai është i preokupuar duke i bërë Atij ibadet, duke i bërë vazhdimisht sexhde dhe ruku. Dhe kur këtë nuk është në gjendje më ta bëj, freskohet me përmendjen e Allahut me gjuhë dhe falënderim, por kur edhe këtë nuk ka mundësi ta bëj, freskohet me përmendjen e Tij me zemër dhe është i zënë me meditim. Ndërsa atë që e do Allahu i jep bujarinë sikurse të detit, butësinë sikurse te diellit dhe nënshtrueshmërinë sikurse të Tokës . Në fund e lusim Allahun me fjalët:. O Allah na bëj neve të duam Ty dhe të gjithë ata që të duan Ty. O Allah, na bëj të dashur çdo punë që na afron pranë dashurisë Tënde. O Allah, bëje dashurinë ndaj Teje më të dashur për ne se vetën, familjen dhe pasurinë tonë. O Allah, pastro zemrat tona nga varshmëria ndaj ndokujt tjetër përveç Teje dhe na bëj prej atyre që i do dhe të donë!

Fatlinda Klinaku 13\2

DUAJA, ARMË E FUQISHME E BESMTARIT

I Madhëruar qoftë Allahu, i Cili për robërit e Tij përveç adhurimeve të obligueshme ka hapur dyer edhe për adhurimet vullnetare! Adhurime, të cilat bëhen në forma të ndryshme. Në grupin e adhurimeve vullnetare hyn edhe lutja nga e cila kemi dy të mira. Njëra nga të cilat është se me lutje adhurojmë Allahun xh.sh. duke u mbështetur në hadithin e Pejgamberit a.s. të cilin e transmeton Nu'man ibn Beshir, se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Lutja është adhurim. Pastaj lexoi ajetin: "Zoti juaj ka thënë: Më thirrni Mua, Unë do t'ju përgjigjem. Ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit Tim, do të hyjnë të përçmuar në xhehenem." (Gafir: 60)

Ndërsa e mira e dytë është që nëse do Allahu ajo do të plotësohet. Lutja është tregues i besimit të pastër në Allahun xh.sh., nëpërmjet të cilit robi arrin suksesin dhe shpëtimin në të dy botët. Kur robi lutet dhe kërkon me sinqeritet prej Allahut, pa i bërë shok Atij, ka plotësuar një pjesë të besimit në Njëshmërinë e Tij.

Çdo musliman, i cili i lutet Zotit të Madhërishëm për ndonjë çështje të caktuar në mënyrë të ligjshme, do të përballet me tri gjëra: ose ia pranon lutjen, ose ia lë për botën e ardhshme, ose e ruan nga ndonjë e keqe. Thotë Ibn Kajimi: "Disa besimtarë, që njihen për asketizmin e tyre thonë: Sa e dashur është për mua që kur të kam një nevojë t'i kërkoj Allahut, i nënshtruar përpara Tij, i vetmuar vetëm me Zotin tim. Askush nuk mund ta marrë vesh. Sekret i fshehtë që vetëm Ai e di. Por sa dëshirë do të kisha që të vonohej plotësimi i lutjes, për të vetmen arsye që mos të më ikë, por të jetë gjithmonë me mua përjetimi i kësaj lidhjeje të ngushtë mes meje dhe Krijuesit."

Lutja e kthen caktimin e Allahut xh.sh., siç është thënë në këtë hadith: "Nuk e kthen caktimin e Allahut asgjë tjetër përveq duasë, dhe nuk sjell jetëgjatësinë asgjë tjetër përveç bamirësisë". Ky hadith do të thotë se lutja bëhet shkak për kthimin e caktimit të Allahut. I sëmuri mund t'i lutet Allahut xh.sh. dhe të shërohet. Por, nëse meditojmë dhe mendojmë thellë këtë çështje, Allahu i Madhërishëm është Ai që e caktoi për këtë njeri që të sëmuret. Po, Allahu është Ai që ia solli ndërmend, ia mundësoi dhe e caktoi që i sëmuri do t'i lutej Atij për ta shëruar. Pra, Allahu xh.sh. është Caktuesi. Në dukje, lutja e kthen caktimin e Allahut, por në thelb të gjitha çështjet përfshihen në orbitën e caktimit.

Prej gjërave të pëlqyeshme gjatë lutjes është edhe thënia e saj në mënyrë të fshehtë. Allahu i Madhërishëm thotë: "Luteni Zotin tuaj të përulur dhe në heshtje." (El-A'araf: 55) Allahu xh.sh. i ka urdhëruar robërit e Tij që të luten shumë, por pa i ngritur zërat. Lutja e fshehtë ngërthen në vete: sinqeritetin dhe edukatën me Allahun. Këto elemente janë faktorë të rëndësishëm për t'u pranuar lutja. Zoti i Madhërishëm në Kur'an përshkruan lutjen e Zekerijas a.s.: "Kur ai thirri Zotin e tij me një thirrje të fshehtë". (Merjem: 3)

Në fshehjen e lutjes ka dobi të shumta. Ibni Tejmije tregon një sërë prej tyre, e ne po mjaftohemi vetëm me disa prej tyre:

-Lutja e fshehtë është tregues i besimt të lartë, sepse robi e di që Allahu e dëgjon lutjen e fshehtë.

-Përulja dhe nënshtrimi në këtë gjendje janë më të plota.

-Sinqeriteti është më i madh.

-Ulja e zërit e bënë zemrën më të nënshtruar, ndër-

sa ngritja e tij e shpërndanë vëmendjen aty e këtu.

-Lutja e fshehtë s'do t'ia dijë për zhurmat, rrëmujën, etj.

Si çdo punë së cilës i shoqëron diçka me qëllim të pranimit të saj ashtu edhe lutja i ka disa shoqërues me anën e të cilëve e bënë atë më madhështore. Ndër këta shoqërues janë edhe:

-Të jetë zemra vigjilente; Thotë Allahu xh.sh..: "Luteni Zotin tuaj të përulur dhe në heshtje."(El-A'araf: 55)

- Vendosmëria në lutje; Për këtë kemi argument hadithin e Pejgamberit a.s. ku thotë: "Në qoftë se dikush e lut Allahun, le të jetë i vendosur. Mos të thotë: O Zot në qoftë se do, më jep! Allahun nuk ka kush ta detyrojë.

- Ndërmjetësimi me punë të mira; Argument për këtë është hadithi i Muhamedit a.s. që flet për tre persona, të cilët u mbyllën në shpellë, pasiqë hyrja ishte bllokuar nga një shkëmb. Kur e panë se nuk kishin asnjë rrugëdalje, atëherë burrat i thanë njëri-tjetrit: kujtoni se mos ndoshta keni bërë ndonjë punë për hirë të Allahut, e luteni Allahun me të, mbase Ai na shpëton nga kjo sprovë.

Derisa më lartë u përmendën faktorët me anën e të cilëve bëhet i mundshëm pranimi i lutjes, tani do të cekim disa nga pengesat e pranimit të saj, e ato janë:

- Të nxituarit në lutje, d.m.th. nëse kërkohet diçka e ndaluar, si, p.sh., nëse kërkohet shkëputja e lidhjeve familjare. Për këtë argument kemi hadithin e Pejgamberit a.s. ku thotë: "Njeriut do t'i pranohet lutja nëse nuk kërkon diçka të ndaluar, shkëputje të lidhjeve farefisnore dhe në qoftë se nuk nxitohet." Shokët e pyetën: "Si mund të nxitohet në lutje o i Dërguar i Allahut?" Pejgamberia.s. tha: "Nxitimi është kur njeriu thotë: Jam lutur, por nuk kishte rezultate dhe pastaj heq dorë nga lutja dhe e humbë shpresën".

Në fund e lusim Allahun e Madhërishëm të na bëjë prej atyre, të cilët nuk e humbin shpresën nga Zoti i tyre dhe që i luten Krijuesit në vazhdimësi.

Jusuf Cej 13/1





O ZOT!

A thua pse ka njerëz aq mizorë?!

Apo, për të arritur qëllime, s'mërziten për fatin tonë.

Përse vrapojnë pas gjërave që një ditë do t'i braktisin?!

Përse sjellin çrregullime në këtë tokë, kur Allahu krijoi çdo të mirë në këtë botë?!

Ah, sikur të mund të bëja diçka për tërë këto dukuri..

Sa do të doja që një ditë të shoh vetëm fytyra të buzëqeshura!

Të mos shohë fëmijë që bredhin rrugëve pa strehë,

Të mos ketë të tillë, ulur nëpër qoshe, duke pritur t›u dal ndokush për ndihmë!

.Sa do të doja që çdo dhunë të zëvendësohet me mirësi...

Blerta Brahimi 11/4

POZITA E FEMRËS NË ISLAM

Njeriu është themeli i çdo civilizimi, por njëkohësisht edhe ndërtues kryesor i atij civilizimi. Për të qenë jeta sa më e lumtur dhe civilizimi të jetë i mirëfilltë, Krijuesi e ndau njeriun në dy gjini, atë mashkullore dhe femërore. Në parim Allahu i krijoi dy gjinitë me vlera të njëjta, ngase të dy gjinitë formojnë nocionin njeri, edhe pse Allahu i dalloi në disa gjëra dytësore.

Varësisht nga koncepti se si e kuptuan këtë, disa menduan se nuk është kështu, por ata menduan se Islami e nënvlerësoi femrën ndërsa mashkullin e ngriti, gjë e cila nuk i përket Islamit. Në vazhdim do të shohim se a është reale kjo që ata menduan apo është ndryshe.

Allahu xh.sh. i krijoi dy gjinitë ashtu siç krijoi ditën dhe natën. Ashtu siç dalloi këto dyja, e dalloi edhe mashkullin nga femra. Siç thotë Allahu xh.sh. në Kur'an:

"Ai (Allahu) bëri për ju natën që të pushoni, ditën e ndritshme (që të shihni), në këtë vërtetë ka argumente për një popull që dëgjon". (Junus, 67)

E si do të ishte puna nëse do të ishte i njëjtë roli i tyre?! A do të kishte jetë normale?! Padyshim se jo, mu për këtë Allahu thotë:

"Thuaj: sikur Allahu ta bënte natën e përhershme e t'ua zgjaste deri në ditën e gjykimit. Ç'mendoni, cili Zot pos Allahut do t'u sillte juve dritë?! A nuk po kuptoni?" (El-Kasas 71)

Pra Allahu xh.sh. nga mëshira e Tij krijoi kohën si origjinë e pastaj e ndau në dy pjesë dhe ua caktoi secilës prej tyre rolin e saj, në të njëjtën mënyrë krijoi njeriun si origjinë e pastaj e ndau në dy gjini dhe secilës prej tyre ia dha rolet dhe detyrat e saj.

Allahu xh.sh. i bëri meshkujt furnizues të familjes, ndërsa femrat i bëri prehje e qetësi për ta.

Për këtë thotë Allahu në Kur'an:

"... Babai i fëmijës është i obliguar për furnizimin dhe veshmbathjen e tyre (grave) ashtu si është rregulli..." (El-Bekare 233)

Kurse femrën e krijoi që të merret me gjëra më të ndjeshme, atë parimisht e obligoi me kujdesin ndaj fëmijëve të saj.

Pikërisht këtu ka ndodhur keqkuptimi, ngase ata (jo muslimanët) menduan se kjo është shkelje e të drejtave të femrës ngase Islami po e izolon atë. Përgjigjja për këtë është e thjeshtë dhe logjike, feja islame nuk ka dashur që ta ulë femrën, por e ka ngritur atë lartë, sepse femrën e obligoi për formimin e një brezi të mirëfilltë, të edukuar e të arsimuar.

Islami femrën nuk e ndaloi nga puna, por punën e la si mundësi alternative për të pasi që atë e bëri faktorë kryesor në edukimin e familjes.

Dëshirojmë t'u tregojmë atyre që kanë mendime jo të mira karshi islamit, se feja islame është fe e mirëfilltë, e pa krahasuar, e cila i ka dhënë vendin e merituar çdo personi dhe nuk e ka nënvlerësuar askënd.

Sejfullah Pantina 13/1

PSE TË LEXOSH?!

A ke menduar ndonjëherë, vallë për çfarë arsye janë themeluar kaq shumë shkolla e universitete të mirëfillta, si në vendin tonë ashtu dhe në mbarë botën?! Pa dyshim se gjithë ato mijëra universitete me ata miliona nxënës kanë një qëllim. Ata s'dëshirojnë tjetër veçse marrjen e dijes dhe largimin nga injoranca. E çelësi më efikas për këtë, normalisht se është leximi.

Njeriu kur lexon ka dobi të panumërta. Ai duke lexuar mbushë hapësirën boshe të injorancës së tij me njohuritë e reja, që fiton gjatë leximit.

Me lexim ai ruan kohën nga humbja e saj në gjëra të kota e të ndaluara. Në të njëjtën kohë ai është i larguar nga shoqërimi me njerëzit e këqinjë, të cilët do të ishin shkaktarët kryesorë të devijimit të tij, shpëton nga ata, ngase ai për vete zgjodhi mikun më të mirë, zgjodhi librin.

Leximi të rrit ambicien e të bën mendjemprehtë, të shton kulturën e të shprehurit, të ndihmon të përfitosh nga përvojat e të tjerëve, gjithashtu ai të largon nga pikëllimet, brengat e përditshme.

Por, kot mundohemi ne të tregojmë vlerën e leximit, kur Allahu xh.sh. për fjalë të parë në librin e Tij zgjodhi fjalën: "Lexo!". Thirrja e Tij drejtuar neve nëpërmjet këtij urdhri, ka një domethënie të veçantë dhe si e tillë na motivon akoma më shumë për të lexuar.

Krahas këtyre dobive të shumta, njeriu gjatë leximit dhe marrjes së njohurive të ndryshme, në të njëjtën kohë bënë ibadet dhe adhuron Zotin e tij, në këtë mënyrë ai ngrihet tek Ai.

Dijetarët tanë të mëdhenj dhe njerëzit e mirë, librin e kishin pasion. Ibni Haxheri (Allahu e mëshiroftë) gjatë tregimit për jetën e Ibni Kajimit thotë: Ibni Kajimi ishte dhënë pas tubimit të librave, ashtu që tuboi shumë libra, aq sa nuk mund të numëroheshin. Kurse fëmijët e tij, pas vdekjes së tij kanë shitur një kohë të gjatë prej atyre librave, përveç atyre që i kanë ndalur për vete".

Ndërsa Ibn Xhehmi tregon dhe thotë: "Kur më pëlqen një libër dhe në të shikoj gjëra të dobishme dhe interesante, vazhdimisht i shfletoj fletët e tij duke shikuar edhe sa fletë më kanë mbetur akoma. Këtë e bëj nga shqetësimi dhe dëshpërimi që libri së shpejti do të përfundojë, e me këtë edhe pushojnë magjitë e tij me të cilat e kam ushqyer shpirtin tim. Sikur Kur'ani të kishte edhe më shumë faqe, gëzimi dhe jeta ime do të ishin më të plota."

Këto, lexues i nderuar janë disa stacione dobiprurëse sa i përket leximit, të cilave duhet t'ju kthehemi herë pas here. Ato shpesh na përkujtojnë t'i marrim, t'i lexojmë ato që të përfitojmë prej tyre.

Arti Mahalla 13/1

INTERVISTË ME

BAJRUSH EF. AHMETIN

Veteran i arsimit në M.M. "Alauddin"

Drita e Kur'anit.: Profesor i nderuar, jeni ndër të parët dhe ndër më të njohurit prej hoxhallarëve dhe profesorëve të Medresesë. Na tregoni diçka për Medresenë dhe rolin e saj në shekullin e kaluar.

Medreseja ka luajtur rol të madh, ngase e ka kthyer shpresën e humbur për të pasur fe edhe në sistemin komunist. Shpresa e humbur ishte kur sistemi e mbylli Medresenë në Prizren në vitin 1948. Atë Medrese e ka udhëhequr Hasan ef. Nahi, Zoti e mëshiroftë! Mirëpo, Bashkësia Islame nuk ndejti duar kryq. Kryetari i atëhershëm i saj Hafiz Bajram Agani ka bërë përpjekjet maksimale në përkrahjen e institucioneve fetare dhe arsimore, ku rrumbullaksoi përpjekjet e tija me hapjen e Medresesë së ultë në Prishtinë. Kjo Medrese nuk shërbente vetëm për muslimanët e Kosovës, por edhe për regjione të tjera rreth saj, siç ishin: Maqedonia, Mal i Zi, Sanxhaku dhe Kosova Lindore. Këtu ka shumë gjëra për të thënë për rolin e Medresesë në Prishtinë, por unë po mjaftohem me atë që ka thënë Imam Vehbi Ismaili – Drejtor i Qendrës së muslimanëve shqiptarë në Detroid. Ai ka vizituar dy herë Kosovën, në vitin 1974 dhe 1978. Ai ishte nga Shkodra, por Shqipërinë nuk ka patur mundësi t'a vizitoj deri sa ka ra sistemi komunist. Ai patë thënë: "Kibla e shqiptarëve është Prishtina", kishte për qëllim se, qendra fetare e shqiptarëve është Prishtina, ngase e ka Medresenë. Atëherë komunizmi ishte në nivel të lartë, si në Shqipëri ashtu edhe tek ne në Kosovë. Por, megjithatë imam Vehbiu thotë se unë shpresoj se do të vijë koha, që unë të marrë imam nga kjo Medrese dhe të dërgoj në Shqipëri, bile edhe në Amerikë. Ai arriti t'a përjetojë shpresën e tij, për deri sa imami Shuajb Gërguri në Detroid, i cili e zëvendësoi imam Vehbiun, është kuadër nga Medreseja e Prishtinës. Gjithashtu, me rënien e komunizmit në Shqipëri, patën shkuar disa hoxhallarë – nxënës të Medresesë së Prishtinës – për të shërbyer atje.

D.K.: Po, për nevojat tuaja gjatë punës në Medrese, a na tregoni diçka?

Fillimi i punës sime si mësimdhënës i Historisë islame ka qenë shumë i vështirë, ngase nuk ka patur literaturë arsimore në gjuhën shqipe. Më është dashur të punoj më shumë se nxënësit., përgatitja për të ligjëruar edhe përgatitje tjetër për të tubuar material për tekstet arsimore. Por, me ndihmën e Allahut xh.sh. në vitin e dytë të mësimdhënies sime kam përgatitë një skriptë – dispencë, e kështu gradualisht i kam bërë edhe librat tjerë për të gjitha klasët veç e veç. Allahu xh.sh. më ka ndihmuar edhe entuziazmi im i madh që kam patur për punë.

D.K.: Çka mendoni, a ishin nxënësit më të përkushtuar në mësime në vitet e kaluara, apo tani?

Nxënësit kanë qenë të përkushtuar në mësime, edhe pse me kushte shumë të vështira, e sidomos në Medresenë e vjetër. E përkushtimin e juaj shpresoj ta keni më në nivel, ngase ju i keni kushtet shumë më të mira dhe rrethanat më në favor se sa gjeneratat e më parshme, andaj edhe suksesi duhet të jetë më i mirë gjithsesi.

D.K.: Keni qenë profesor i historisë për disa vite, çfarë mund të na thoni për rëndësinë e mësimit të saj?

Hoxhallarët janë përcjellur dhe ndjekur nga regjimi i sistemit komunist, janë penguar në kryerjen e misionit të tyre fetar, janë nënçmuar, duke i akuzuar se, hoxhallarët merren me çështje të prapambetura dhe se po manipulojnë me popull.

Historia islame ka rëndësi të madhe, ngase ajo na mëson për shoqëritë njerëzore, duke spikatur elementin ideologjik të tyre që nga njeriu i parë e këndej. Duke filluar nga tregimet e pejgamberëve – më të dashurit e Allahut xh.sh., ku një prej synimeve të këtyre tregimeve është marrja shembull e karakterit të pejgamberëve në jetën tonë të përditshme, e në veçanti të pejgamberit të fundit Muhamedit a.s.. Për të vazhduar më tej me rrjedhat e ngjarjeve që kanë ndodhur gjatë periudhave të ndryshme kohore, të cilat e përcjellin përhapjen e Fesë Islame, etj, e deri në ditët e sotme.

D.K.: Sa ishte e vështirë të ishe hoxhë në sistemin e kaluar?

Në sistemin e kaluar ka patur vështirësi dhe sfida prej më të ndryshmëve. Hoxhallarët janë përcjellur dhe ndjekur nga regjimi i sistemit komunist, janë penguar në kryerjen e misionit të tyre fetar, janë nënçmuar, duke i akuzuar se, hoxhallarët merren me çështje të prapambetura dhe se po manipulojnë me popull. Sa për ilustrim po u'a përmendi një rast që mua më ka rastisur kur unë përfaqësoja Këshillin e Bashkësisë Islame të Prishtinës, në një tubim zyrtar në kohën e komunizmit. Më datën 13 12 1978, në rubrikën "Kronisti" të gazetës "Rilindja" – e vetmja gazetë në atë kohë – një gazetar shkruante: "Feja është helm, hoxhallarët po e turbullojnë ujin dhe po peshkojnë". Po në atë muaj ishte caktuar Kuvendi Vjetor i Lidhjes Socialiste të Komunës së Prishtinës, ku edhe unë isha delegat nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Prishtinës në Lidhjen Socialiste. Në atë mbledhje u diskutuan shumë gjëra, kurse unë paraqita rastin e gazetarit të sipërpërmendur dhe thash se, unë nuk di për ndonjë rast që është helmuar dikush nga feja dhe ka vdekur, si dhe i bëra me dije të pranishmëve se, shtypi kuvajtian ka nxjerrë në pah se, muslimanët në Jugosllavi nuk i kanë të drejtat e barabarta, për mbështetje ata kishin shkrime zyrtare nga gazeta "Rilindja". Diskutimet rreth asaj që unë fola, filluan menjëherë, ku u paraqit një grua delegate dhe tha: "Unë habitem me këtë djalë të ri (e kishte fjalën për mua), në vend se t'a sulmoj fenë, ky e mbron atë". Ajo vazhdoi dhe tha: "Unë di rast që nën ndikimin e fesë, kur fëmijët sëmuren dhe kanë temperaturë nuk i dërgojnë tek mjeku, por u lidhin pejë të kuq në dorë, me shpresë se do të shërohen". Pas përfundimit të kësaj mbledhjeje, ka patur shumë zëra që kanë shkuar në Komisionin për Çështje Fetare dhe kanë thënë për mua se, ky njeri ka sjellë ide nga vendi ku ka studiuar, etj.

D.K.: Pas një pauze nga shkolla keni rifilluar shkollimin e mesëm dhe studimet, që për ne paraqet diçka të veçantë, çka iu motivoi për këtë?

Unë gjatë procesit të arsimimit kam bërë pauzë dhjetë vjeçare, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike. Megjithatë, asnjëherë nuk i kam humbur shpresat, duke pritur se një ditë do të më ipet rasti që të vazhdoj mësimin. Shkollimin e kam ndërprerë në vendlindje, e në vitin 1954 jemi shpërngulur nga fshati Orllan – komuna e Podujevës – dhe jemi vendosur në Prishtinë. Edhe në qytet jam marrë me punë bujqësore deri kur e kam kryer shërbimin ushtarak. Pas shërbimit ushtarak kam kryer privatisht klasët e mbetura të fillores, deri sa e kam kompletuar filloren të plotë. Kur u punësuan tre vëllezërit e mi, atëherë u thash a më lejoni mua tani të vazhdoj shkollimin? Përgjigjja e tyre ishte po, veç a do t'ia dalësh. Në vitin 1961 Medreseja ishte ende e ulët, një vit kam prezentuar në Medrese si dëgjues vetëm në lëndën e Kur'anit, ngase dija të lexoja nga pak. Në

Sa i përket shamisë dhe edukatës fetare nëpër shkolla, unë do të thoja se realizimi është i sigurt, por kërkohet punë dhe urtësi para dhe gjatë zhvillimit të këtij procesi.

vitin 1962 Medreseja u avansua nga Rangu i Ulët në të Mesëm. Megjithëse ishte në pyetje mosha, pas shërbimit ushtarak nuk lejohej me qenë nxënës i rregullt në shkollë të Mesme. Mirëpo, drejtori i atëhershëm Haxhi Ismail ef. Hakiu më tha: po shoh se interesimin për arsimim e ke me zemër, andaj eja si dëgjues në të gjitha lëndët dhe në fund duhet me i dhënë provimet klasore për vitin e parë, e pastaj në të dytën do të regjistrohesh i rregullt, dhe ashtu veprova. Pra, kështu e kam kryer Medresenë i rregullt me plotë dëshirë. Pas përfundimit të Medresesë kam vazhduar studimet në Universitetin e Bagdadit, si dhe atë, sikur edhe shokët e tjerë e kam kryer për katër vite, jo pse kam qenë shumë i zoti, por se kam punuar intenzivisht gjatë katër viteve të studimeve. Pra, ky ka qenë entuziazmi im për nxënien e diturisë.

D.K.: Na flisni pak, se cili është opinioni i juaj sa i përket shamisë dhe edukatës fetare nëpër shkolla, a do të ketë sukses në këtë pikë?

Sa i përket shamisë dhe edukatës fetare nëpër shkolla, unë do të thoja se realizimi është i sigurt, por kërkohet punë dhe urtësi para dhe gjatë zhvillimit të këtij procesi. Është interesant me këta pushtetarët tanë që e kanë plotë gojën demokraci një njërën anë, e nga ana tjetër i shkelin të drejtat e njeriut dhe e diskriminojnë shumicën e popullatës, apo siç po thonë tani komunitetin muslimanë. Diskriminim më të madh nuk ka se sa, me ja ndërprerë një vajze vijimin e shkollimit në shkollë publike vetëm pse e mbanë shaminë! Disa thonë ferexhe, a thua nuk dinë të bëjnë dallimin mes shamisë dhe ferexhesë, apo nuk duan ta dinë. Ferexhja është eliminuar në vitin 1948, atë e mbajë në mend edhe unë. Për mua është e habitshme që askush nuk reagon për femrat që vallëzojnë dhe këndojnë rrugëve e shesheve gjysmëlakuriq, ndërsa reagojnë për një vajzë që vë shami në kokë?! A thua cila është normale dhe morale. Sa i përket edukatës fetare në shkolla, po të kishte edukatë fetare nuk do të kishim gjendjen që e kemi. Ne jemi dëshmitarë në atë që po e inçizojnë mediat elektronike nëpër shkolla, e sidomos mbrapa shkollave, se sa tmerr duken "shpricat" që rinia jonë merr drogë, pinë alkool, merren me prostitucion, mbajnë armë të ftohta dhe pijnë duhan, e që kohëve të fundit pirja e duhanit nëpër institucione është e ndaluar edhe me ligj. Kur e them këtë kam parasysh se, Medreseja është hapur në vitin 1951 si e Ulët, e nga viti 1962 si e Mesme, aty asnjëherë nuk ka patur këso pamje tmerruese, aty as nuk ofendohen e as nuk fyhen mësimdhënësit si në shkolla tjera. Unë e kam ende në krye dhimbjen që e kam ndie para disa viteve kur dëgjova në lajme se është rrahur arsimtari në njërën prej shkollave të Mesme publike në Kosovë. Se si është e mundur që nxënësi me ngritë dorë në atë që e mëson! E së fundi edhe deklarata e presidentes Jahjaga është irituese për besimtarët e besimit islam, e cila thotë prerazi se shamia nuk do të lejohet kurrë, se Kosova është shtet laik! Presidentja, nëse e ndien veten presidente e të gjithëve, atëherë ajo duhet t'i konsideroj ato si bija të veta, a thua a do t'i largonte bijat e veta nga shkolla?! Është interesante të përmendet se si pushtetarët tanë janë aq të padrejtë ndaj fesë islame, sa që këtë nuk e shprehin ndaj të tjerëve. Unë kam parë thuajse të gjithë në mesha në kishën katolike për krishtlindje ose për pashkët, kurse nëpër xhamia nuk i kam parë! Ministri që e ka dhënë urdhrin administrativ që vazhdon ende të zbatohet, në të njëjtën kohë, ai i ka paguar pagat e priftrinjve ortodoksë që i mësojnë fëmijët nëpër shkolla.

D.K.: A ndiheni krenarë për profesionin që patët dhe për rrugën e jetës që ju zgjodhët?

Nuk di si të e shprehi krenarinë time madhështore për profesionin që e kam zgjedhur. Për hirë të modestisë, këtë do t'a dëshmonin më mirë ish nxënësit e mi, e që tani, ata janë kuadër i vyeshëm kudo nëpër institucionet tona fetare e më gjërë. E kam përmendur edhe një herë në një intervistë të zotëri Rexhep Sumës – kryeredaktor i Diturisë Islame –, ku ndër të tjera kam përmendur se për 32 vite si mësimdhënës kam humbur vetëm tri orë, por duke i'a bërë me dije se për punët e mia personale, e jo për ndonjë punë zyrtare, apo rast të sëmundjes. Unë kam llogaritur se një orë e imja është së paku 35-së orë, ngase çdo nxënësit i'a kam humbur një orë. Kënaqësia ime ka qenë kur e kam marrë ditarin dhe kam shkuar në klasë.

D.K.: Për në fund, një mesazh për nxënësit e Medresesë dhe për të gjithë lexuesit e revistës sonë.

Mesazhi im për nxënësit është të mos u shkoj koha kot, por t'a shfrytëzojnë atë maksimalisht. Këtu, dua t'ua përcjellë një porosi të ish kryetarit të Bashkësisë Islame, Haxhi Mustafë ef. Canhasi, i cili na pat thënë neve kur ishim nxënës në vitin 1962, gjatë një vizite që i bëri Medresesë: "Mos e humbni kohën, se çdo gjë kompensohet, apo çdo gjë që të mungon del në pazar e blenë atë përveç kohës, atë nuk mund t'a gjesh askund për t'a blerë.

intervistuan: Arti Mahalla&Hajrullah Kerolli
13/1

RREGULLOJE JETËN DUKE PËRMENDUR ALLAHUN

Secili besimtar që beson Allahun duhet ta dijë rëndësinë e kësaj jete. Duhet ta dijë që Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar qoftë, nuk na ka dhuruar kohë dhe momente të pavlefshme në këtë jetë. Allahu xh.sh. nuk dëshiron që ne thjeshtë t'i shfrytëzojmë begatitë e kësaj dynjaje. Allahu ka krijuar për ne një botë fisnike dhe të bukur, kështu që, mund ta zbukurosh jetën tënde përmes nënshtrimit ndaj Allahut, mund ta zbukurosh jetën tënde përmes dashurisë për Atë që ta ka dhuruar jetën. Andaj, këtë mund ta bësh përmes angazhimit me të cilin Allahu është i kënaqur. Prandaj për shkak të mirësive të Allahut mbi robin është Ai i Cili na frymëzon ta shfrytëzojmë jetën në mënyrën e duhur. Na frymëzon drejt shfrytëzimit të momenteve dhe orëve ashtu si duhet dhe për këtë shfrytëzimi i jetës në punë të dobishme është një mall fitimprurës me të cilin njeriu mund të bëhet nga njerëzit, të cilët i janë afruar afër Allahut.

Vallë, sa ditë na shkojnë e zemrat tona largohen nga Zoti i tyre dhe sa janë netët që zemrat janë tjetërsuar-larguar nga Krijuesi i tyre? Kur një njeri i ka të mbushura orët dhe momentet e tij me punë të mira, atij nuk do t'i kalojë asnjë orë në ditë dhe asnjë orë gjatë natës e që nuk do ta falënderoj dhe përmend Allahun. Allahu ka zbritur te ne Kur'anin fisnik dhe ka dërguar pejgamberë për t'i bindur njerëzit që t'i nënshtrohen Allahut, Zotit të njerëzve dhe xhinëve. Na kanë mësuar se nata dhe dita e besimtarit duhet të jenë udhëtim drejt kënaqësisë dhe bindjes ndaj Allahut. Me të vërtetë një nga punët më të mira që do të veprojë njeriu në këtë dunja është përmendja e Allahut.

Pejgamberi a.s. në një udhëtim u tha shokëve të tij: "Muferridunët i kaluan të gjithë." Sahabët e pyetën kush janë Muferridunët o i Dërguar i Allahut? Ai tha: "Ata burra dhe gra të cilët e përmendin Allahun xh.sh. shumë."

Janë ata zemrat e të cilëve janë ngjallur nga përmendja e Tij dhe falënderimi i Tij duke shpresuar dhe dëshiruar mëshirën dhe xhenetin e Tij. Allahu xh.sh. thotë në një ajet: "O ju që besuat, përkujtoni Allahun sa më shpesh dhe madhërojeni Atë mëngjes dhe mbrëmje." (Ahzab, 41, 42)

A nuk e dini se, nëse përmendni Allahun, Ai do t'ju përmend juve? Dhe nëse ju e kujtoni Atë në vetën tuaj, atëherë Ai ju kujton në Vetën e Tij. Dhe nëse e përmendni Allahun në mexhlise, (takime) atëherë Allahu i Lartësuar do t'ju përmend në një grupim edhe më të bukur. Përkujtoje Allahun sa më shpesh që të mund t'i arrish ata të cilët të kanë tejkaluar!

Mërgim Shala 13/1



NËNA

Është natë dhe bie shi. Kam ndezur një qiri e tymi i tij shpesh më bie drejt e në fytyrë. Shiu përplaset fortë në dritare dhe melodia e tij përzihet me melodinë e këngës duke më shtyrë thellë në mendime. Nën dritën e këtij qiriu të vogël që pak nga pak shuhet, po shkruaj pak fjalë për krijesën më të bukur e më të dashur në botë. Për personin më të mrekullueshëm. Për NËNËN. Për atë, e cila brenda meje jeton si një mbretëreshë.

Kudo që shkoj i kujtoj fjalët e saj. Kudo më shfaqet fytyra e saj me ata dy sy të shndritshëm qiellor që ndriçojnë si shkëlqimi i diellit në një ditë të freskët pranvere. Dal të shikoj pranë dritares dhe me gisht shkruaj emrin e saj në të. Ashtu duke shikuar fillova t'ia bëja disa pyetje vetes. Përse vallë shumë gjërave e shumë njerëzve nuk ua dimë vlerën sa i kemi pran?! Përse mos ta bëjmë nënën tonë njeriun më të lumtur në botë?! Përse mos ta bëjmë të ndihet krenare për ne?! Lotët më rrëshqasin nga sytë. Shkronjat i shkruaja shtrembër e dora më dridhej. Shkrimin tim nuk e kuptoja! Më dhembte shpirti për shumë gjëra që i kisha bërë, e për shumë të tjera që nuk i kam bërë. Shkenca ka zbuluar ilaçe për shumë sëmundje, por për shpirtin asnjë! Por, edhe të zbulonin, unë e di se nuk do të kishin efekt, sepse ilaçi i vetëm i shpirtit tim, je ti nëna ime e çmuar dhe buzëqeshja jote.

Seide Hoti 11/4

VETËBESIMI

Vetëbesimi, gjëja themelore për njeriun që të ketë sukses në tejkalimin e barrierave të krijuara nga rrethanat për një çështje të caktuar. Është një cilësi që duhet ta ketë çdo njeri, i cili sadopak në mendjen e tij ka për qëllim të ketë sukses në ndonjë punë apo drejtim.

Qëllimi, synimi, ideali i njeriut është ai që më së shumti dëmtohet nga mungesa e kësaj cilësie. "Unë mundem" është fraza që duhet mishëruar jeta jonë me të. Mungesa e kësaj fraze është barriera e parë dhe më e madhe që shkakton stagnimin, molisjen, zbehjen e mundësisë për të pasur suksese në ndonjë gjë.

-Kur flasim për vetëbesimin, kemi për qëllim atë në masë të caktuar, duke mos kaluar në të tepruar. Vetëbesimi në masë të tepruar është rreziku më i madh që na kanoset. Pra, kjo veti e mirë në parim, mund të shndërrohet lehtë në veti, cilësi tjera, të cilat nuk përkojnë me natyrshmërinë e njeriut, siç janë mburrja dhe mendjemadhësia.

Pse mos të bëhemi shembull praktik i vetëbesimit?! Pse mos të jemi ata ndaj të cilëve drejtohet gishti, kur është fjala për suksesin?! Pse jo kur NE MUNDEMI?!

Qendrim Cakaj 13/1

Pres përgjigje

E zhytur në mendime, nuk di kujt t'i drejtohem, shikoj fletët e bardha e s'di çfarë të shkruaj. Deri kur me këtë padituri?! Kur shoh njerëz që vrasin kohën! Dua dielli të rrezoj e të bëhet jeta nurë, dritë e syve t'mi! Dua të shkruaj që midis rreshtave të kem lulen e dritës. Nëse nuk do me gjeni në mesin e këtyre rreshtave, atëherë s'do më gjeni as aty ku isha. Dua të jetoj e të bëhem një engjëll që nga qielli të lëshoj lot, të jetoj dhe ta falënderoj Krijuesin tim. Por, nuk dua të harroj që vdekjen e kam pranë. Dua obligimet e Zotit t'i zbatoj dhe të kem zemrën e mbushur me plot iman, e jo t'i lë anash e të them: Të lutem Zot kthemë, ku mbeta të filloj!

Ardiana Llugiqi 13/2

TROKAS POR...

Mijëra arsye për një jetë. Në miliona gjëra, kërkoj një derë. Qëndroj para saj e shtangur, e ngrirë... Ndjej sikur humbë shikimin, dëgjimin, të folurit vetëm mendoj.

Thellohem në veten time dhe s'di çfarë të bëjë! Kërkoj të hapej ajo derë para meje, por kot. Të dridhura ma kapluan zemrën time të vockël! Derdha lot nga sytë që nuk i ndjeja.

Trokita, por se hapi askush! E djegur edhe e harruar thash në vete! Askush nuk më mbeti të më hap një derë!

Hapu derë! Liromi rrugët! Sikur dera mu përgjigj: Kam humbur fuqinë, jam plakur... Kuptova se qëndroj në derën e humbur!

Ah, sa u frikësova, sikur toka u rrotullua nën mua. Me vrap u afrova, provova ta hap derën, sikur mu përgjigj: Kalo, por çudi, dera nuk u hap! Fillova të bërtas, të trokas...

U ndjeva si më e palumtura, e pashpresa në këtë botë.

Sikur nuk doja të ngrihesha nga toka!

Për një moment pash sikur para meje u shfaq një binarë dhe njerëz që prisnin një tren. Treni erdhi dhe dera u hap vetvetiu. U ktheva dhe unë në vetën time. E kuptova se Allahu nuk mbyll një derë pa hapur një tjetër.

Djellëza Beqiri X/3

PSE NUK FALESH?!

Pse nuk falesh kur e di se Allahu i Madhëruar të urdhëron ta falesh namazin?

Pse nuk falesh kur e di se namazi ishte porosia e fundit e Muhamedit, lavdia dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, para vdekjes së tij?

Pse nuk falesh, kur e di se namazi është çelësi i çdo mirësie?

Pse nuk falesh kur e di se ai që nuk e fal namazin ka bërë mëkat të madh?

Pse nuk falesh kur e di se namazi i lan gjynahet?

Pse nuk falesh kur e di se përkujdesja për namaz është rruga për të hyrë në Xhenet?

Pse nuk falesh kur e di se namazi është gjëja e parë nga veprat për të cilën do të japësh llogari Ditën e Kiametit?

Rijad Jaha 10/1



TRE MINISTRAT

Një ditë një mbret i thirri tre ministrat e tij dhe kërkoi që secili prej tyre të marrë një shportë dhe të shkojë në kopsht te pallati për t'a mbushur përplot me gjëra të mira nga frutat e ndryshme që kishte aty. Po ashtu kërkoi prej tyre që të mos kërkojnë ndihmën e askujt në këtë detyrë dhe nuk duhet të ndihmohen me njëri-tjetrin. Ministrat shprehën habi me kërkesën e mbretit, por megjithatë morën secili prej tyre nga një shportë dhe shkuan në kopsht.

Ministri i parë, për të kënaqur mbretin, mblodhi të gjitha frutat e mira duke zgjedhur lloje të ndryshme dhe e mbushi shportën plotë. Ministri i dytë ishte i bindur se mbreti nuk ka nevojë për këto fruta për veten e tij dhe se ai nuk do t'i shikojë frutat, andaj filloi të mbledh frute si i vinte më lehtë, disa të pjekura e disa të kalbura deri sa e mbushi shportën ashtu si ishin marrë vesh. Ministri i tretë nuk besojë fare se mbreti do të interesohej në përmbajtjen e shportës, prandaj e mbushi atë me barishte dhe gjethe pemësh ashtu si i vinte më lehtë. Ditën tjetër, mbreti urdhëroi të vijnë ministrat me shportat e tyre dhe atë çfarë kishin mbledhur. Kur ministrat u takuan me mbretin, ai urdhëroi ushtarët të marrin të tre ministrat dhe t'i dërgojnë në një burg të largët për tre muaj, çdo njërin prej tyre veç e veç me shportat që kishin, ku nuk do të mund t'i arrinte askush dhe po ashtu i ndaloi ata nga çdo ushqim tjetër, pos asaj që kishin në shportat e tyre.

Ministri i parë jetoi mirë dhe përballoi tre muajt duke ngrënë frutat e mira që kishte mbledhur. Ministri i dytë, jetoi tre muaj duke qenë në gjendje të vështirë, pasi që detyrohej të hante vetëm frutat e pjekura, të cilat nuk i mjaftonin sa duhet për jetë. Kurse ministri i tretë vdiq nga uria që në muajin e parë, pasi që nuk kishte asgjë me vete pos barishteve dhe gjetheve.

Pra, pyesni veten, cilit lloj të njerëzve u takoni? Ju tani jeni në kopshtin e botës, jeni të lirë të grumbulloni vepra të mira ose të liga, por nesër kur urdhri i Mbretit të mbretërve të jetë që ju të burgoseni në varrin e errët dhe të ngushtë të tokës, aty ku do të jeni vetëm, çfarë mendoni se do të ju sjell dobi pos veprave tuaja të mira që keni bërë në këtë botë?

Kujdes!

Imagjino sikur sot të jetë dita e fundit e mbetur për ty në këtë botë, çfarë do të punoje që nesër në botën tjetër t'i mbushësh duart me begatitë e Ahiretit? Vepro sot, sepse nesër është vonë të pendohesh!

Lavdim Gërguri 12/1

TRI SHKAQE PËR
LUMTURI

1. Çka ka kaluar, ka mbaruar

Kujtimi i së kaluarës dhe ndikimi nga të kujtuarit e saj, e edhe pikëllimi për fatkeqësitë e saj, është marrëzi dhe budallallëk, e gjithashtu edhe vrasje e vullnetit dhe shkatërrim i jetës që tani e jeton. A mos ndoshta dëshiron që lumin ta kthesh në burim, apo diellin në vendlindjen e tij, apo fëmijën në barkun e nënës, apo lotin në sy?! Të lexuarit në librin e kujtimeve të së tashmes, shqyerje e mundit, eksplodim i çastit të tanishëm. Ai që kthehet në të kaluarën i ngjason atij i cili bluan miellin, e ai në esencë është i bluar, apo ai që e sharron tallashin e drurit. Që moti kanë thënë për ata që e qajnë të kaluarën: "Nuk nxirren të vdekurit nga varret e tyre". Njerëzit nuk shkojnë përpara e as që kthehen prapa, ngase era përpara shkon, uji përpara zbret, karvani përpara ecë, andaj mos e kundërshto zakonin e jetës.

2. Krijo prej limonit pije të ëmbël

Njeriu i ditur dhe i mençur di ta shndërroj humbjen në fitore, gjersa i padituri nga një fatkeqësi i bënë dy. I Dërguari a.s., ishte i dëbuar nga Meka, andaj u vendos në Medine dhe në të formoi një shtet, për të cilin kanë dëgjuar të gjithë historianët e botës.

Ahmed ibni Hambeli është burgosur dhe është rrahur me kamxhik, por pastaj u bë imam i tërë myslimanëve. IbnTejmije është burgosur, por pastaj u bë dijetar i shquar. Sarhasi është burgosur në fund të një pusi, por nga aty ka dalur me njëzet vëllime mbi Fikhun.

Kur të vijë ndonjë fatkeqësi, shiko andej nga mund të vijë shpëtimi. Kur dikush të ofron një gotë lëng limoni, hidh në të sheqer. Nëse dikush të dhuron një gjarpër, shfrytëzoje lëkurën e tij të çmuar, kurse pjesën tjetër lëre. Nëse të kafshon akrepi, dije se kafshimi i tij është mbrojtje për trupin tënd nga helmi i gjarprit.

"Mund të mos doni diçka, ndërsa ajo është më e mirë për ju" (El-Bekare: 216)

Në një burg ndodheshin dy poetë të dënuar me vdekje, njëri optimist, ndërsa tjetri pesimist. Para daljes para xhelatit, shikuan në dritaren e burgut. Optimisti e drejtoi shikimin kah qielli e yjet dhe buzëqeshi. Tjetri shikoi baltën në rrugicën afër burgut, kurse fytyrën ia njomën lotët. Mendo për këta dy njerëz dhe dije se e keqja nuk është e përhershme, ndërsa e mira është e tillë.

3. Merre mjaltin, por mos e thyej kosheren

Butësia është stoli për gjithçka. Ajo i largon të gjitha brengat. Mënyra e butë e bisedës, buzëqeshja e sinqertë kur është e vështirë dhe një fjalë e bukur, të gjitha këto janë petk i të lumturve. Këto janë edhe virtyte të besimtarit të mirë, i cili është sikur bleta. Ajo ushqehet me gjërat më të mira, prodhon gjënë më të mire dhe kur ulet në një lule, nuk e dëmton atë, sepse Allahu i bekon ata që janë të butë dhe të kujdesshëm, e jo ata që janë të vrazhdë dhe të dhunshëm. Kështu ka njerëz për shkak të të cilëve zemrat fërgëllojnë, shpirtrat mahniten dhe shikimet zbuten, ngase njerëzit e tillë në mesin tonë janë të pëlqyer. Fjalët e tyre janë të mira qoftë kur na japin ose na marrin diç, qoftë kur shesin apo blejnë, vijnë apo shkojnë.

Arritja e miqësisë me të vërtetë është mjeshtëri që e njohin njerëzit fisnik dhe bamirës. Ata janë të rrethuar gjithnjë me grupe miqsh. Kudo që janë të pranishëm në shoqëri ndjehet hare dhe gëzim. Nëse mungojnë, të tjerët pyesin dhe luten për ta. Këta njerëz e kanë një parim etik i cili thotë:

"Të keqen ktheje me të mirë, ndërsa armiku yt befas do të bëhet shok i ngushtë" (En-Nahl: 97)

Para emocioneve të tyre të ngrohta, mirësisë së sinqertë dhe faljes, shkrihet urrejtja. Ata harrojnë të keqen, por e kujtojnë të mirën. Qortimet dhe fjalët e ndyta nuk i marrin me zemër, por lejojnë që jehona e tyre të tretet në largësi pa kthim. Njerëzit janë të sigurt dhe të qetë prej tyre.

"Mysliman është ai nga gjuha dhe dora e të cilit janë të sigurt myslimanët tjerë. Besimtar është ai nga i cili është e sigurt pasuria dhe jeta e njerëzve të tjerë."(Hadith)

Këta njerëz i pret shpërblimi i paqes së menjëhershme, i qetësisë dhe i mendjes së qetë. Po ashtu i pret shpërblimi i madh trupor dhe shpirtëror në afërsi të Zotit që falë shumë, në xhenete dhe lumenj.

"Vërtetë, besimtarët e devotshëm do të jenë në kopshte të Xhenetit, ku rrjedhin lumenjtë, tek një Sundues i Plotfuqishëm." (El Kamer: 54,55)

Dijetar Guri / Hajrullah Kerolli 13/1

Pjesë të shkëputura nga librat "Mos u dëshpëro" dhe "Tridhjetë shkaqe për lumturi" nga AidEl-Karni

SA ÇUDI!

Çudi si një shumë të hollash duket aq e madhe kur e japim në xhami dhe aq e vogël kur e shpenzojmë në tregti.

Çudi sa të gjata janë dy orë të kaluara në xhami e sa të shkurtra janë kur shohim ndonjë film.

Çudi sa vështirë është të kujtojmë diçka kur lutemi dhe nuk kemi aspak vështirësi për të menduar gjëra, që duhet t'i themi shokut, thjesht për muhabet e për të shtyrë kohën.

Çudi si gëzohemi kur loja e futbollit zgjatet për disa orë dhe ankohemi kur "Taravija" gjatë Ramazanit është më e gjatë se zakonisht.

Çudi sa rëndë është për të lexuar një ajet në Kur'an dhe sa lehtë është të lexohen disa gazeta apo revista rresht, brenda ditës.

Çudi si njerëzit duan të ulen në vendet e para në ndonjë lojë apo shfaqje, dhe shtyhen të mbeten në rreshtat e fundit në xhami, me qëllim që të largohen sa më shpejt.

Çudi si na nevojiten 2-3 javë kohë për të programuar ndonjë takim apo mësim në xhami, ndërsa për gjëra të tjera e ndërrojmë orarin pa vështirësi, qoftë edhe në çastin e fundit.

Çudi sa rëndë është për njerëzit të mësojnë një ligjëratë aq mirë sa për t'ua treguar edhe të tjerëve, dhe sa lehtë u vjen t'i kuptojnë dhe t'i përsërisin thashethemet.

ÇUDI... APO JO ?!

Benjamin Emini 12 /1





MOS HARRO

Allahun, Ai të ka krijuar
Islamin me këtë fe, je i shpëtuar
Muhamedin, rrugës së tij për të shkuar!

Veten tënde, rrugën e drejtë mos e lësho,
Familjen, këshillat nga ajo mos i harro!

Shokun e mirë, në punë të mira të ka drejtuar
Shokun jo të mirë edhe nga ai ke mësuar.

Prindërit e dytë, errësirën e jetës ta kanë ndriçuar,
Shoqërinë e sinqertë, në dua për ti kujtuar.

Mos harro
Mëkatet, nxito të pendohesh!
Pendimin, nga ai të përmirësohesh,
Vdekjen, që do të ndajë nga kjo botë,
Varrin, për errësirën e së cilit nuk dyshohet dot,
Ditën e gjykimit, kur para Zotit do të japësh llogari,

MOS HARRO ALLAHUN,
AI NUK TË HARRON TY!

Anita Gërguri 12/3

I HUMBURI

Ah, sillem vërdallë në rrugët e baltosura në mesin e mjegullës, e cila përplaset me fytyrën time sikurse anija me valët e detit.

Anije, gjendja e së cilës përkon me brendësinë time të brishtë, poshtë-lartë, para-mbrapa. Mirëpo, ajo se çfarë e dallon brendësin time me anijen, është kapiteni, i cili e drejton në qëllimin e saj pavarësisht se çfarë përballon gjatë kalimit të saj në det. Mua më mungon një i tillë.

Më mungon kapiteni pa të cilin jam i zymtë. Frymarrjet e mia bëhen të vështira, e më të vështira. Shtrëngimi që ma kaplon gjoksin, ngjason me shtrëngimin e duarve të dy të dashuruarve, burim i të cilit shtrëngim është dashuria e madhe e tyre. Por, çfarë e bënë shtrëngimin e gjoksit tim të jetë aq i pamëshirë, aq i vrazhdët, hakmarrës. Përse?! Pa prit pak! Anija e cila arriti synimin e vet, direktivat i morri nga pikënisja.

Po unë?! Tik-taket e fuqishme dhe të shpejta të zemrës sime, që duket se kanë marrë rrugën për të dal nga vatra e saj. Është ndjenjë e re, e panjohur për mua, ndoshta pse është hera e para që dëgjojë zemrën time të thotë diç. Dhe, ajo e tha. Zemra rënkoi duke thënë; Islami. Urraaa, u gjet kapiteni, mjaftonte njëherë ta dëgjoja zemrën për të kuptuar se ç'më mungonte.

QendrimCakaj 13/1

PARAPËLQEJ MIRËSINË E JO DHUNËN

Përse fytyrat e fëmijëve të lahen me lot çdo ditë?!
Përse nënat të vajtojnë për fatin e tyre?!
Përse të dëgjohen krismat e armëve në çdo kohë?!
Përse të ketë dhunë e varfëri në mesin tonë?!

O ZOT!

A thua pse ka njerëz aq mizorë?!

Apo, për të arritur qëllime, s'mërziten për fatin tonë.

Përse vrapojnë pas gjërave që një ditë do t'i braktisin?!

Përse sjellin çrregullime në këtë tokë, kur Allahu krijoi çdo të mirë në këtë botë?!

Ah, sikur të mund të bëja diçka për tërë këto dukuri..

Sa do të doja që një ditë të shoh vetëm fytyra të buzëqeshura!

Të mos shohë fëmijë që bredhin rrugëve pa strehë,

Të mos ketë të tillë, ulur nëpër qoshe, duke pritur t'u dal ndokush për ndihmë!

Sa do të doja që çdo dhunë të zëvendësohet me mirësi...

Blerta Brahimi 11/4

MBULESA IME

Shumë njerëz gabojnë,
se fare pak mendojnë.
Urdhrin e Allahut përbuzin,
fundin se kujtojnë.

Sa e sa gjykime
për mbulesën që në kokë mbaj.
Pse zemrat e ngurta nuk gjykojnë drejtë
Vallë a unë kam faj?!

Një mbulesë e artë,
një mbulesë plot vlerë,
një mbulesë e vlefshme,
që më jep shumë nderë.

Hykmete Rexha 12/3

MUHAMEDI A.S.

Errësirë ishte kudo
Injorancë mbretëronte
Kishte humbur çdo arsye
Bota dritën e kërkonte

Në Mekë, n'këtë vend të bekuar
U lind i dashuri i Perëndisë
Muhamedi i lavdëruar
Shpëtimtari i njerëzisë

O Muhamed o i dërguar
Dritë dhe mëshirë për mbarë njerëzinë
Salavate duke t'kënduar
Falënderojmë Perëndinë

Ti je dritë që kurrë nuk fikesh
Flakadan - Udhëzim hyjnor
N'zemrat tona gjithmonë rritesh
N'ty gjejmë prehje përgjithmonë

Gjithmonë ishe dhe do t'mbetesh
Ideal - Shembull për ne
Fjalët tua kurrë nuk zbehen
Deri sa t'ketë jetë mbi dhe.

Arbnor Sinani 12/1

MEDRESE

Janë bërë një vit që jam brenda teje.

Aty ku fillova të mësoj më shumë për jetën, mësoj Kur'anin dhe fenë e vërtetë.

Aty mësova ta shoh bukurinë e kësaj bote.
Thjesht, mësova përse kam ardhur në këtë botë!

Epo, kjo nuk është e gjitha, sepse vetëm një vit kalova aty.

Dashtë Zoti që edhe këto dy vite t'i kaloj në mirësi!
Kurrë në jetën time s'jam ndier kaq e lumtur, shoqërinë që takova këtu dhe çdo gjë të bukur.
Po, po, ky është rrisku im.
Edhe kur vetmia të kaplon,
e vetme nuk je.
Zemra me pak zë thërret, Medrese!

Razije Isufi 11/4

PAK

Pak qetësi në këtë botë
Duan të gjithë njerëzit sot.
Të gjithë jemi në pritje të ndryshimit
Të ditëve të lumtura mes njerëzimit.
Ndryshimi vjen nga vetë ne
Jemi e ardhmja, rini e re.
Pak minuta, që në namaz harxhohen
Janë më të vlefshme, se minutat që kot kalohen.
Për pak ajete kuranore që lexon
Me mijëra sevape ti fiton.
Për pak hapa drejt xhamisë
Afrohesh më shumë drejt mirësisë.
"Pak"në jetë për t'u penduar,
"Shumë"në jetën e amshueshme.
Të jesh i shpëtuar.

Ikballe Ilazi 11/3

TË LUTEM TY

Të falënderoj o Allah, për çdo gjë që më ke dhuruar,
Jam mëkatare e di, faljen tënde gjithmonë kam dëshiruar.
Elhamdulilah me dije, mendjen ma ke ndriçuar,
Në rrugën e drejtë, vetëm ti më ke udhëzuar.
Të lutem më bëj çdo ditë më të përmirësuar,
Ma hap zemrën, forcoma vullnetin, gjithnjë për të të adhuruar.
Mëshiroi prindërit e mi, janë ata që më kanë edukuar
Jam muslimane, për këtë ndihem e bekuar.
Për Muhamedin a.s, të falënderoj që e ke dërguar,
Të lutem Ja Allah, na dhuro Xhennetin të gjithëve të bashkuar!

Medina Hoti 10/4

LUTJE QË NUK REFUZOHEN

1. Lutja e besimtarit për vëllain e tij mysliman në mos praninë e tij;
2. Lutja e atij që i është bërë padrejtësi;
3. Lutja e udhëtarit;
4. Lutja e agjëruesit në kohën e iftarit dhe lutja e prijësit-imamit të drejtë;
5. Lutja e atij që është në vështirësi;
6. Ai që e kalon natën i pastër (me abdest) duke e përmendur Allahun;
7. Lutja e atij që zgjohet nga gjumi;
8. Lutja e fëmiut të sinqertë për prindërit e tij;
9. Lutja e atij që e përmend Allahun shumë;
10. Duaja e atij që e do dhe e ka mëshiruar Allahu.

Brendona Gashi 13/2



KUR

Kur është radha ime,
që atë vend ta vizitoj?
Zemra të më gëzohet ,
syri të më lotoj.

Kur do të shoh nga afër ,
ah, moj Qabe e bekuar !
Të më mbushet zemra plotë jetë,
për këtë fe, për Allahun e Madhëruar.

Kur do të nisem tek ti,
e t'i kthej shpinën kësaj bote?
Ta braktis acarin e kësaj jete
tek ti oj Qabe, nga ngrohtësia jote?

Kur do të vrapoj në Safa e në Mërva?
Kur do të bëj dua në Arafat me plot gëzim?
Kur do të jem afër teje o vend i bekuar?
Kur do ta vizitoj varrin e më të dashurit të Zotit tim?

Shpresoj kjo ditë të vie,
dashtë Zoti të ma mundësoj!
Pranë teje të jem o vend i bekuar,
me zemër Fuqiplotin ta falënderoj!

Emine Tershani 12/3

MIRË SE VJEN NË FAMILJEN TONË TË MADHE

Dashuria, ngrohtësia dhe harmonia janë elemente kyçe që i nevojiten njeriut kur ndërron vend. Janë komponentë që i mundësojnë atij një përshtatje më të shpejtë me rrethin dhe vendin në përgjithësi. Këto i dhurohen çdo gjenerate që ia mësyn Medresesë Alauddin, shkollë që numëron më shumë se gjysmë shekulli që nga themelimi i saj. Prandaj, edhe në këtë vit gjenerata e sivjetshme përjetoi pritje të veçantë, përjetoi ndjenja të cilat u shprehën atyre nga nxënësit e klasave më të larta dhe kolektivi i shkollës në përgjithësi. Ishte organizimi i bërë në amfiteatrin e shkollës nga nxënësit, që përfshinte lexim nga Kur'ani, dialogë, ilahi, ligjërata, e pjesë tjera nga programi të cilat ngërthyen në vete emocione të papërshkrueshme. E tërë kjo u bë surprizë për mikpritje vëllazërore të klasave të dhjeta, të cilat nga sivjet u bënë pjesë e jona e pandashme. Drejtori i Medresesë Bahri ef. Simnica në fjalimin e tij u shprehu mirëseardhje gjeneratës së re dhe u uroi atyre suksese përgjatë shkollimit në këtë vatër të shenjtë. Ai u premtoi atyre se Medreseja për ata do të jetë shtëpi e dyta dhe do të luaj rolin kyç në edukimin e tyre.

Prandaj, edhe një herë Medreseja dëshmoi se është "servile" ndaj nxënësve sa i përket dashurisë dhe ngrohtësisë, duke i bërë ata të pajisen jo vetëm me një shoqëri të re, por me një FAMILJE TE MADHE.

FESTOHET DITA E SHKOLLËS

Medreseja edhe këtë vit festoi ditën e themlimit të saj. Kjo ditë u manifestua me një program modest përgatitur nga nxënësit e kësaj shkolle. Në program morën pjesë: drejtori, i gjithë personeli edukativo arsimor si dhe nxënësit.

Pas leximit të bukur të një pjese të Kur'anit, nxënësve iu drejtua drejtori i shkollës Bahri ef. Simnica me një fjalë rasti, ku ndër të tjera përmendi kontributin dhe suksesin e madh që pati kjo shkollë përgjatë punës së saj.

Programi ishte mjaft i pasur, një poezi dhe monolog të përgatitur nga vetë nxënësit, ilahi të ndryshme nga kori i shkollës si dhe pjesa humoristike.

Të gjithë pjesëmarrësit u ndanë të kënaqur me këtë organizim, duke shpresuar që aktivitetet e tilla nuk do të mungojnë edhe në të ardhmen, gjithmonë me suksese të mëdha në këtë tempull të dijes.

Vesel Sylejmani 13/1

MEDRESANTËT NDIHMOJNË FAMILJET SKAMNORE

Edhe në këtë vit traditën vazhduam, por më ndryshe nga vitet e tjera.

Këtë vit në prag të festës së Kurban Bajramit, medresantët u solidarizuan me familjet skamnore që edhe ata sado pak t'i gëzohen kësaj feste.

Me datën 11.10.2013, ditë e premte, kryesia e Shoqatës së Nxënësve të Medresesë së bashku me disa nga profesorët, vizituan familjet skamnore.

Vendet të cilat i vizituam ishin: lagjja e Kuvajtit në Komunën e Podujevës dhe lagjja e komunitetit RAE në Komunën e Fushë-Kosovës. Edhe këtë vit nxënësit treguan gatishmëri për të kontribuar sado pak, duke mos kursyer kohë e as mund e që tani më veç e kemi bërë traditë. Vizituam pesëdhjetë familje, ku për çdonjërën ndamë nga një paketë me gjëra ushqimore dhe mish të kurbanit.

Nuk duhet lënë pa e përmendur edhe kontributin e drejtorisë së shkollës sonë, e cila çdoherë ndihmon, përkrah dhe mbështet çdo aktivitet që ndërmerr shoqata e nxënësve.

Të gjitha familjet që ne i vizituam na falënderuan. Shpresoj që për këto familje të ketë sa më shumë të interesuar që tu sjellin sa do pak ngrohtësi.

Fatime Islami 12/3

PROMOVIM LIBRI

Më 01.11.3013 kremtuam Ditën e shkollës, përvjetorin e 62 - të. Këtë vit ishte pak më ndryshe se përvjetorët tjerë, sepse pikërisht në këtë ditë u promovua libri me titull: «Jeto, mendo, ndrysho « i nxënëses sonë Anita Gërguri.

Në kuadër të këtij manifestimi nxënëset përgatitën një program modest, të begatuar me ilahi, monologje e poezi.

Vlerat e këtij tempulli janë të shumta, dita -ditës shtohen, duke bërë kështu që çdo gjeneratë që del nga ajo të jetë fitimtare ,sepse është pikërisht ky vendi nga i cili çdonjëri mëson qëllimin jetësor. Fillimisht fjalën e mori drejtori i shkollës Bahri ef. Simnica, i cili ishte më meritori për këtë manifestim duke uruar nxënëset për suksese të vazhdueshme. Uroj nxënësen për punën e bërë dhe shumë suksese tjera. Uroj dhe porositi nxënëset që të vazhdojnë me shkrime, sepse fjala e shkruar është ajo që nuk vdes kurrë, dhe ndër tjera premtoi se përkrahjen do ta kenë të gjithë, andaj ne u jemi përherë mirënjohës e që përkrahja dhe mbështetja në kërkesat tona nuk mungoi asnjëherë. Fjalën e morën edhe lektori ,Besnik Jaha dhe redaktori prof. Fadil Hasani. Në këtë rast nuk munguan as fjalët falënderuese për drejtorin dhe kolektivin e kësaj shkolle të z.Remzi Gërgurit prindit të Anitës. Mbetemi me shpresë se çdo gjeneratë që do të vijë pas nesh, të jenë përherë të mira.

Eliza Bublaku 13/2

Shoqata e nxënësve të Medresesë i uron Myftiut rizgjedhjen e tij

Udhëheqësit e Shoqatës nga Medreseja e djemëve dhe vajzave të shoqëruar edhe nga kujdestarja e paraleles së vajzave Prof. Shahë Memishi vizituan myftiun Mr.Naim ef. Ternava. Ata u pritën përzemërsisht nga Myftiu dhe bashkëpunëtorët e tij në Kryesinë e Bashkësisë Islame në Prishtinë. Me këtë rast përfaqësuesit e shoqatës uruan Myftiun për rizgjedhjen e tij në krye të këtij institucioni, duke i dëshiruar suksese të mëtutjeshme. Ata gjithashtu e falënderuan ate për kujdesin që Kryesia e Bashkësisë islame ka ndaj Medresesë dhe sukseseve të saj. Nga ana e tij Myftiu Ternava shprehu mirënjohjen e tij për këtë vizitë, e cila siç tha ai, është ndër më të veçantat. Ai me nostalgji kujtoi kohën kur ishte si profesor në Medrese e pastaj edhe drejtor i saj, duke shtuar se Medreseja ka qenë dhe do të jetë përherë nga prioritetet e Bashkësisë Islame. Ai uroi nxënësit për punën e tyre dhe shprehu gatishmërinë e tij për t'ju përgjigjur kërkesave të tyre në vazhdimësi.

Festim Kerolli 13/1

A E DINI SE ?

1. Nëse një person qeshë shumë madje edhe për gjëra të kota thellë në vetvete, ai është i vetmuar;

2. Nëse një person flenë më shumë se që duhet, ai është i dëshpëruar;

3. Nëse një person flet pak dhe shpejt, ai mban në vetvete sekrete;

4. Nëse një person s`mund të qajë, ai është tip i dobët ;

5. Nëse dikush ushqehet në mënyrë të ç'rregullt, ai është i tensionuar;

6. Femrat i mbyllin sytë gjatë ditës dy herë më shumë se meshkujt;

7. Femrat i pulpulisin qepallat tri herë më shumë se meshkujt;

8. Një studim i kohëve të fundit ka arritur përfundimin se, nëse shihni filma horror, mund të humbni peshë, nëse shihni 90 minuta një film horror, mund të digjni deri në 113 kalori;

9. Kërmilli mundë të flejë deri në 3 vjet;

10. Delfini flenë me njërin sy hapur;

11. Miza sheh rreth 100 imazhe brenda sekondës;

12. Kinezët i lëshojnë bletët në lëkurat e tyre,për të mos u rrudhur.

Azemine Kaçiu & Amina Rrustemi 12/3

THËNIE TË MENÇURA NGA NJERËZ TË MËDHENJ

"Plaga që shkakton gjuha është më e keqe se plaga e thikës." Aliu r.a.

"Nëse brenda teje dëgjon zërin qortues ndaj veprave dhe fjalëve tua, atëherë dije se ti ende je gjallë." Halid el-Bekër

"Sikur të paraqitej dituria në fotografi, do të ishte më e bukur sesa pamja e diellit dhe e hënës." Ibni Kajim

"Mos e lejo askënd që fëmijës tënd t'ia mësojë suren el-Fatiha para teje, për arsye se ai gjithë jetën do të falet me të." -Ahmedel-Axhmi

"Bëhuni si pema, të cilën njerëzit e gjuajnë me gurë, ndërsa ajo ju lëshon frute." Hasan el-Bena

"Dija është pasaporta jonë për të ardhmen, sepse e nesërmja do të jetë zotëruesja e atyre, të cilët përgatiten për të që sot." Malcolm X.

Vesel Sylejmani 13/1

URTËSI

Durimi është të harrosh ankesën;

Nga shenjat e sprovimit të një njeriu është mos shikimi i të metave të veta;

Ai që shijon ëmbëlsinë e dijes, nuk duron dot të qëndroj larg saj;

Besimtari ka katër shenja; Fjalët e tij janë dhikër, heshtja e tij është meditim, shikimi i tij në çdo gjë është mësim dhe puna e tij është mirësi;

Përvoja edhe njeriun që e ke pran ta largon, ndërsa mendimi çdo të largët ta afron;

I dituri kupton me fjalë, i mençuri kupton me shenja;

Frika dhe shpresa janë dy frerë që të ndalojnë nga edukata e keqe;

Mos u lodh të edukosh atë që nuk edukohet dhe as të drejtosh atë që është e shtrembër;.

O ti që shite gjithçka për hiçgjë, dhe që bleve hiçgjë me gjithçka;

Distancat e dynjasë kalohen me këmbë, ndërsa distancat e ahiretit kalohen me zemër;

Nëse frika banon në zemër, atëherë gjuha nuk do të flasë përveç atyre gjërave që i takojnë;

Thjeshtësia është të pranosh të vërtetën prej kujtdo;

Nuk ke nga jeta jote përveç se një frymëmarrje të vetme, nëse nuk e përdor në favorin tënd, mos e përdor kundër vetes tënde;

Nuk ka hyrë në zemrën time asgjë e kotë, qysh ditën që kam njohur Allahun;

Shamia është dritë që nuk harxhohet, shtyllë që nuk rrëzohet dhe obligim që nuk zëvendësohet;

Jeta s'ka vlerë, nëse njeriu zhvishet nga edukata, shija dhe respekti;

Çdo fillim ka mbarimin, çdo gjë ka qëllimin;

Vetëm dy lloje njerëzish nuk zhduken nga kujtesa e jetës tonë, ata që na e dhanë dorën në ditët e vështira dhe ata që na lanë vetëm kur kishim nevojë;

Miqtë e vërtetë janë si yjet,ndriçojnë zemrën tonë, pikërisht atëherë kur errësira mbizotëron më shumë se kurrë.

Të heqësh dorë nuk do të thotë gjithmonë që je e dobët, ndonjëherë do të thotë se je mjaftueshëm i fortë të lësh diçka të largohet;

Rëndësia e njeriut nuk matet me vendin që ai zë, por me boshllëkun që ai le kur ikën;

Vjen një moment në jetë dhe e kupton se kush ka rëndësi, kush nuk ka pasur dhe kush nuk do të ketë kurrë.

Florentina Hasanaj & Florentina Sheqiri 12/3

ËNDRRA MU BË REALITET

Që nga fëmijëria ëndërroja të ulesha në bankat shkollore të Medresesë "Alauddin", të mësoja qoftë edhe gjërat më të thjeshta. Mjafton që të filloj me emrin e Allahut, e t'i përshëndes profesorët dhe motrat muslimane me përshëndetjen më të ngrohtë islame *"Essela-mualejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu"*. Falënderimi i takon Allahut që ma mundësoi te jem edhe unë nxënëse e kësaj shkolle që e dëshiroja aq shumë. Ndihem e privilegjuar që i takoj kësaj shoqërie që e takova këtu e që jo rastësisht i quaj të zgjedhura nga Allahu xh.sh. Shpresoj me lejen e Allahut të luftojmë për dituri, ngase dituria është dritare e hapur për të gjithë, me anë të së cilës njeriu njeh botën përreth. Fjalët janë të pakta e gjuha është e varfër për të përshkruar ndjenjën e të qenit nxënëse e kësaj shkolle, sepse është ndjenjë që nuk mund të përshkruhet me pak fjalë, por kur përjetohet qenka e pa përshkruar!

Ti o Krijues i Gjithësisë,

që ma mundësove fjalën Tënde ta mësoj!

Çdo ditë e natë të falënderoj,

nuk mjafton sa Ti e meriton.

Fjala Jote madhështore

qetëson zemrat e myslimanëve.

Ishte dhe do të mbetet,

mbi jetën e kësaj bote.

Rineta Nitaj: 10/4

XHENETI

O ti që e dëshiron Xhenetin,
vallë për të a punon?
Ditët e jetës në dynja,
vallë si po i shpenzon?

Kalojnë ditët me shpejtësi,
jeta jote po shkurtohet.
Çdo ditë e njëjta histori,
pritet një ditë që të pendohet.

Vallë mendon ti o njeri,
se ke kohë për tu penduar?
Kush të ka dhënë garanci
që je kaq i siguruar?

Xheneti fitohet me vështirësi,
jo në dynja duke u argëtuar.
Se qejfi e rehatia bëhen në shtëpi,
jo përgjatë rrugës i hutuar.

Kjo dynja është kalimtare,
një ditë prej saj ke për tu larguar.
Tek Allahu do të kthehesh
i gëzuar ose i pikëlluar.

Ti e zgjedh sesi vepron,
në këtë dynja që shpejt kalon,
ditët e jetës tënde,
e kohen se si e shpenzon.

Duhet punë dhe durim,
e jo të kalosh kohën pa menduar,
por sekondat e jetës t'i shpenzosh,
Allahun duke adhuruar.

Ti thua se
Xhenetin e dëshiron,
por me veprat e tua
çfarë tregon?

Pendohu për kohën e kaluar,
ktheju Allahut të Lartësuar
Veten tënde përmirësoje,
e lidhjen me Allahun forcoje.

Të është dhënë Një Jetë,
Një mundësi,
Se si e shpenzon,
këtë e zgjedh ti.

Nëse në Xhenet
do i lumtur të shkosh,
mos harro se për Të
duhet të punosh!

Rijad Jaha 10/1



VETJA IME

Po filloj me trupin,
Një krijesë e përsosur.
Po Filloj me shpirtin,
Në trupin tim i vendosur.

Dhe ti o zemra ime,
Një pjesë për vendime.
E ti oj fytyra ime,
Për mua ke shumë kuptime.

T'i besosh Allahut,
Në mënyrën më të mirë.
Do të thotë t'i besosh Allahut,
Me dëshirë dhe i lirë.

Eh i mjeri unë,
Sa vite më kaluan,
Edhe sa do marrë frymë,
Unë në këtë udhëtim.

E sa dielli kaloi mbi krye,
E sa retë që kaluan me shi,
E sa netë të qeta me yje,
Edhe hëna bashkë me ta.

Qysh s'jam ndalur pak të mendoj,
Vetëm pesë minuta t'ia kushtoj,
Këtë liri që e gëzoj,
A thua vallë kush ma dhuroi?

Ai është Allahu im,
Që më sjell mua gëzim,
Në vetmi dhe shoqëri,
Falënderimi i takon Atij.

Saimir Halitaj 11/2

KURIOZITETE PËR MACET

1. Zemra e një maceje rreh 110/140 herë në minutë

2. Macet janë aq fleksibël, sepse brinjët me kurrizin janë të lidhur me anë të muskujve dhe jo vetëm me ligamente.

3. Një mace merr frymë rreth 26 herë në minutë.

4. Shtylla kurrizore e maces është një mekanizëm, që mund të sillet nga të gjitha anët si tek gjarpri.

5. Macet dhe të gjithë gjitarët kanë vetëm dy lloj grupe gjaku A dhe B.

6. Ato mund të shikojnë shumë mirë me 1 të 6-tën e dritës, krahasuar me atë që i nevojitet njeriut.

7. Një sy i tyre mund të shikojë deri në 250° ndërsa të dy shikojnë deri në 180°.

8. Ngjashmëria mes maces dhe njeriut në shikim është se të dy shikojnë në mënyrë binokulare (me të dy sytë).

9. Macet nuk shikojnë vetëm bardhë e zi siç mendohej, ato mund të shikojnë edhe jeshilen & blu-në. Mendohet se shikojnë edhe të kuqen.

10. Ato mund të dallojnë format e objekteve si rrethore, katrore, drejtkëndore, madje edhe një formë pjate nga ajo tredimensionale.

Lendrit Sahiti 12/1

SIMETRI MATEMATIKORE

Vështroni me vëmendje të gjitha veprimet e mëposhtme. Të gjitha kanë një simetri që të bëjnë të mendosh!

3 x 37 = 111
6 x 37 = 222
9 x 37 = 333
12 x 37 = 444
15 x 37 = 555
18 x 37 = 666
21 x 37 = 777
24 x 37 = 888
27 x 37 = 999

1 x 9 + 2 = 11
12 x 9 + 3 = 111
123 x 9 + 4 = 1111
1234 x 9 + 5 = 11111
12345 x 9 + 6 = 111111
123456 x 9 + 7 = 1111111
1234567 x 9 + 8 = 11111111
12345678 x 9 + 9 = 111111111
123456789 x 9 +10 = 1111111111

0 x 9 + 8 = 8
9 x 9 + 7 = 88
98 x 9 + 6 = 888
987 x 9 + 5 = 8888
9876 x 9 + 4 = 88888
98765 x 9 + 3 = 888888
987654 x 9 + 2 = 8888888
9876543 x 9 + 1 = 88888888
98765432 x 9 + 0 = 888888888
987654321 x 9 – 1 = 8888888888
9876543210 x 9 – 2 = 88888888888

Lavdim Gërguri 12/1

suduku

	3			8				6
7				3	5			
		9				1		
	5				8			7
4	6			2		3	5	1
				1		5		4
	1			9			7	
5		4		7				

TURNIRI NË FUTBOLL

Një pasdite të nxehtë të gjithë nxënësit vrapuan drejt fushës së futbollit. Pjesëmarrja e tifozëve ishte jashtzakonisht e madhe dhe secili shikues mundohej të gjente një vend me të përshtatshëm për t'i shikuar ndeshjet.

Në këtë turnir morën pjesë gjithsej 14 ekipe, dhe në xhiron e parë pas hedhjes së shorteve u ballafaquan këto ekipe:

XII-1 (ekipi i parë) 5:0 XI-1 (ekipi i parë)

X-2 (ekipi i tretë) 0:5 XII-1 (ekipi i dytë)

XIII (ekipi i parë) 4:1 X-1 (ekipi i dytë)

X-1 (ekipi i parë) 2:1 XII-2 (ekipi i dytë)

XIII (ekipi i dytë) 7:2 X-2 (ekipi i parë)

XIII (ekipi i parë) 9:1 X-2 (ekipi i dytë)

XI (ekipi i parë) 2:1 X-1 (ekipi i tretë)

Ndeshjet u përcollën gjithmonë me brohoritje dhe duartrokitje të pareshtura të shikuesve.

Pamë shumë lojëra të bukura, pasime të shpejta dhe konkretizime të bukura, sikur të ishin ndeshje profesionale. Pas këtyre ndeshjeve të mrekullueshme u zhvillua xhiroja e dytë. Rezultatet e xhiros së dytë ishin:

XIII (ekipi i dytë) 2:0 X-1 (ekipi i parë)

XIII (ekipi i parë) 1-0 XII-2 (ekipi i parë)

XII-2 (ekipi i parë) 0-2 XII-1 (ekipi i dytë)

XII-2 (ekipi i parë) Pa lojë.

Intensiteti i lojës gjithmonë shkonte në rritje e sipër, ndërsa tifozët ishin shumë kureshtarë të dinin emrat e finalistëve.

Erdhi koha të zhvillohen gjysmëfinalet, ku u ballafaquan këto ekipe:

XIII (ekipi i dytë) 3-1 XII-1 (ekipi i parë)

XIII (ekipi i parë) 4-1 XII-1 (ekipi i dytë)

Në ditën e premte pas orës së tretë u zhvillua finalja e shumë pritur ku do të luanin ekipet më të suksesshme të këtij turniri.

Kjo lojë u luajt në pranin e shumë shikuesve, të cilët brohoritën pareshtur.

Vlen të theksohet se në finale morën pjesë dhe profesorët, të cilët shikonin ndeshjen me shumë interesim dhe vëmendje.

Finalja u zhvillua në mes të ekipit të parë dhe të dytë, të vitit të katërt, ku përfundoj me rezultat:

XIII (ekipi i parë) 3:1 XIII (ekipi i dytë)

Tre golashënuesit më të mirë të këtij turniri ishin:

Vesel Sylejmani, 9 Gola

Halit Ismajli, 5 Gola

Ardian Krasniqi, 4 Gola

Adhurim Tolaj 13/1

	Rruga e jetës sime	Hartë (ang)	Pasthirrmë	Mbiemri i shkencëtarit Galileut	Tallje e fshehur	Dan (prap)	shkr. e parë (Shqip)	Zakonet	Trajtë e shkurtër	Mbiemri i Presidentit të Amerikës	Lumi më i gjatë në Botë	Hadith i dobët	
Imagjinim (ang)													
Shkretëtirë Arabe							Sheshi 4 Zot (arb)						
Lucky Plant			Qetësuese për fëmijë Albania						Halifi i fundit E.D.				
Zanorja e parë		Shkr.18 arb. Kafshë/pa shq.				Njëriu i parë në botë (pa shq)					F Vazhdoje fjalen ORA..		Atdhe
Përmallim (Populllore)						E re në fe Tregim i gjatë						Vanadi Rendi (populllore)	
I.R.			Unaza e ... L						Padrejtësi (populllore)	Matës i kohës Besim (arab)			
Inat					Oksigjeni E imja (gj.m)		Botë tjetër E kundërta e "I vjetër "						
Shkronja e 18		Numër shkurt		Aftësi për të kopjuar dikë A.B							Natriumi Taliumi		
Në (ang)			Emër mashkulli Puna (Fizik)					Banorët e Taifit adhuronin					
	Prijësi i jahudive							Emër femëror dhe mashkullor					

Hana Murati & Albulena Mëziu

"Lexojeni Kur'anin,
sepse ai do të ndërmjetësojë
Ditën e Kijametit për ata që e kanë lexuar"
hadith